



Programi i teknologjisë

ALBANSKA

Utbildningsinfo

Skolverket

Programi i teknologjisë, si përgatitje për shkollën e lartë, të çon deri në një provim me diplomë që mundëson pranimin tënd në shkollën e lartë.

Programi i teknologjisë të drejtohet ty që dëshiron të punosh me teknologjinë dhe me proceset teknike. Shkollimi është bazë për studime të mëtejshme të teknologjisë dhe të shkencave të natyrës në shkollën e lartë. Ti do të fitosh kompetencë edhe në lëmi të tjera.

PESË DREJTIME TË VEÇANTA

Disenj (dizajn) dhe zhvillimi i produkteve

- Ti merr njohuri për disenj (dizajn) dhe zhvillimin e produkteve, duke u fokusuar mbi disenj dhe konstruksione të drejtuara nga kompjuteri.

Teknologjia e informacionit dhe teknologjia e mediave

- Ti merr njohuri për teknologjinë e informacionit, të komunikimit dhe të mediave të ndryshme si komunikim me kompjuter, programim, media digjitale dhe zhvillim web.

Teknologjia e prodhimit

- Ti mëson për prodhimin dhe ndërtimtarinë si dhe për automatizim dhe kontrollimin e vijave të prodhimit.

Ndërtimi shoqëror dhe ambienti

- Ti mëson për ndërtimin shoqëror, ambientin dhe arkitekturën, ku teknologjia ka rëndësi të njëjtë si ekologjia, pamja dhe ekonomia.

Shkenca e teknologjisë

- Ti merr njohuri për metodat e punës në shkencën e teknologjisë, si dhe vegla për modelim matematik, simulim, kontrollim dhe rregullim.

Përmbajtja e arsimit

Ti zhvillon njohuritë e tua të teknologjisë, fizikës, kimisë dhe matematikës duke u fokusuar në proceset teknologjike. Ti mëson cilat janë lidhjet midis elementeve të ndryshme në zhvillimin teknologjik dhe kupton se si zhvillimi teknik bëhet në shoqëri. Ti studion si teknologjinë aktuale dhe zhvillimin e teknologjisë së re.

Programi është i planifikuar në këtë mënyrë

Në programin e teknologjisë lëndët e përbashkëta të gjimnazit janë: gjuha angleze, historia, edukimi fizik dhe shëndetësor, matematika, shkencat natyrore, njohuritë fetare, shkencat shoqërore, gjuha suedeze ose suedishtja si gjuhë e

dytë. Në programet me përgatitje për shkollën e lartë ti studion më shumë kurse teorike se sa në programet profesionale.

Lëndët karakteristike të përbashkëta në programet janë: Fizika, kimia dhe teknologjia.

Ti ke mundësi specializimi dhe zgjerimi brenda programit. Kjo quhet studime të thelluara. Mund të përfshihen p.sh. këto lëndë: Arkitektura, artet figurative, biologjia, energjia elektrike, teknika e evenimenteve, filozofia, fizika, gjeografia, historia, shoqëria e qëndrueshme, teknologjia mjeksore, teknologjia e rritit, pedagogjia, programimi, psikologjia, suedishtja dhe teknologjia web. Bëj pyetje në shkollë cilat janë lëndët për studime të thelluara që ofrohen.

Ti ke gjithashtu një zgjedhje individuale për të vendosur ç'ka dëshiron ti të studiosh. Bëj pyetje në shkollë cilat janë kurset që ofrohen.

Format e punës

Në program ti kërkon dhe përpunon të dhënat nga burimet me sy kritikë. Ti po nisesh nga problemet praktike të cilat ti i zgjidh bashkë me të tjerët ose në mënyrë të pavarur, shpesh në formë projekti. Ti ushtrohesh në aftësitë e tua për të zhvilluar zgjidhje të reja dhe kreative, dhe ti mëson më shumë se si drejtohet një ndërmarrje.

Ti ushtrohesh në analizim, modelim, simulim, në vlerësime të besueshmërisë, të zhvillimit, të lidhjeve, në konkluzione dhe argumentime për të kuptuar sa më mirë sistemet teknologjike.

Ti e stimulon kureshtjen dhe krijimtarinë tënde dhe mendimin tënd kritik. Ti do të fitosh përvojë të mirë në përdorimin e teknikës dhe pajisjes moderne.

Punim Gjimnazi

Në përfundim të Programit të teknologjisë duhet të përpilosh një punim gjimnazi. Ti duhet të parashtrosh një problem, të planifikosh, zbatosh dhe vlerësosh një punë tematike, me pikënisje nga lëmi të rëndësishme njohurie në program.

Vini re

Nëqoftëse ti kërkon një kompetencë të posaçme për një arsimim në shkollën e lartë, është me rëndësi që të planifikohen studimet e tua. Bisedo lirisht me një këshilltar studimi ose profesioni, nëse ti dëshiron të vazhdosh studimet në shkollën e lartë.

Ti ke gjithmonë të drejtë, brenda zgjedhjes individuale, për të zgjedhur edhe një kurs të edukimit fizik dhe shëndetsor si dhe një kurs estetik.